

34

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, gjyqtari Refki Piraj, me procesmbjatesen Halime Nixha, sekretare juridike e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër te pandehurve H. A. , dhe L. K. , qe te dy nga Prizreni, te akuzuar sipas aktakuzës së PTH ne Prizren PP/II.nr.1715/14,te dt. 20.04.2015, për shkak të veprave penale të lëndimit te lehte trupor nga neni 188/1/1.4 dhe 188 par.3/1.4 të KP-së, në prezencën e të akuzuarve, prokurorit te shtetit Besim Susuri, më dt.15.11.2016, muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit :

H. A. , e lindur me ne Prizren, me banim ne rr. H. , nga i ati M. , e ema Haj. , e lind. E. , nuk ka asnjë klase te shkollës te kryer, e martuar nene e 6 femive, e pa pune, e gjendjes se dobët ekonomike, - rrome - shtetas i R. te Kosovës.

L. K. , i lindur me ne Prizren, me banim ne rr. J. , nga i ati M. , dhe e ema Z. , e lind T. , ka te kryer tri klase te shkollës fillor, e i martuar babe i femive, punëtor, i gjendjes se dobët ekonomike – rrrom shtetas i R. te Kosovës,

JANË FAJTOR

E akuzuara H. A. ,

I. Se me datën 01.07.2014 ne Prizren, ne rr. " " i shkakton lëndim te lehta trupor te dëmtuarës vajzës se saj J. K. , qe rezulton me dëmtim te përkohshëm ne shëndet ne atem enyre qe pas nje mosmarrëveshje ne mes vete e godet te dmetuarën me koke ne karike ku i shkakton lëndime te lehta trupore dhe ate plage shqyese e ndrydhëse ne koke shtrëngim i dorës dhe qafës,

-keso dore ka kryer veprën penale lëndim i lehta trupor nga neni 188/1 te KP-së.

I akuzuari L. K. ,

II. se me date dhe vend te njejte ne nje kohe me vone i shkakton lëndim te lehta trupor te dëmtuarës bashkëshortes se tij H. A. , qe rezulton me dëmtim te përkohshëm te shëndeti ne ate menyre qe pas nje mosmarrëveshje per shkak se e kishte rrahur te bijën J. K. , e godet te dmetuarne me shuplaka ku i shkakton lëndime te lehta trupore dhe ate ndrydhje ne qafe dhe ne shpine,

-keso dore ka kryer veprën penale lëndim i lehta trupor nga neni 188/3 te KP-së.

35

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 41, 49, 50, 51 dhe 52 te KP te akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Te akuzuara H... A...

Me burg ne kohezgjatje prej 3 (tre) muaj cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (nje) viti nga dita e plotufqishmeris se ketij aktgjykimi, nese e pandehura nuk kryen veper te re penale.

Te akuzuarit L... K...

Me burg ne kohezgjatje prej 3 (tre) muaj cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (nje) vitesh nga dita e plotufqishmeris se ketij aktgjykimi, nese i pandehrui nuk kryen veper te re penale.

Obligohen te pandehurit qe me menyre solidare ti paguajnë qe ti paguajë te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato behën ne baze te llogarisë se gjykatës, ne emër te ekspertizës mjeko ligjore secili prej tyre shumen prej nga 10 euro, kurse ne emër te te paushallit gjyqësor te paguaj secili shumen prej nga 15 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotufqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcënimi te ekzekutimit te dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore ne Prizren, i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzën PP.nr. PP/II.nr.1715/14, te dt. 20.04.2015, kunder te pandehurive H... A... dhe L... K... qe te dy nga Prizreni, për shkak të veprave penale të lëndimit te lehte trupor nga neni 188/1/1.4 dhe 188 par.3/1.4 të KP-së.

Te pandehurit H... A... dhe L... K... ne filim te shqyrtimit filestar, në tërsi kanë pranuar veprën penale e cila iu vehet në barrë sipas aktakuzës.

Gjyqtari gjykues, pas marjes se mendimit edhe nga ana e prokurorit te shtetit ka vlerësuar se një pranim i tille ka mbështetje ne provat te cilat i përmban aktakuza, prandaj pranimin e fajsisë e ka aprovuar.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit, plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale për shkak të veprave penale të lëndimit te lehte trupor nga neni 188/1/1.4 dhe 188 par.3/1.4 të KP-, iu shqiptoi dënimin me kusht, duke qenë i bindur se me këtë lloj dënimini do te arrihet qëllimi i të njejtës.

Me rastin e vërtetimit te dënit për veprën penale, gjykata vlerësoi te gjitha rrethanat te cilat në kuptim te nenit 73 te KP-së ndikojnë ne përcaktimin e lartësisë se dënit.

36

Gjykata çmoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese secilën ne veçanti dhe lidhshmërinë ne mes te tyre me te gjitha rrethanat tjera te cilat ishin me ndikim ne përcaktimin dhe qëllimin e dënimit.

Si rrethana renduese gjykata kishte parasysh intensitetin e rezikimit apo dëmtimit te vlerës se mbrojtur, kurse ne rrethanat lehtësuese pranimin e fajit pendimin për veprën dhe rrethanat familjare.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është mare ne kuptim te nenit 450 dhe 452 të te KPP-se.

Vendimi mbi udhezimin ne kontest civil u muar ne kuptim te nenit 463 par.2 te KPPsë.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.789/15 te dt.15.11.2016

Procesmbjatesja:
Halime Nixha

Gjyqtari:
Refki Piraj

DHEZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankes, në afat prej 15 ditesh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit ne Prishtine , e nëpërmjet të kesaj gjykate.